

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Të pathënat e jetës së Alket Rizait, mes burgjeve të Greqisë dhe arratisjeve spektakolare - REPORT.AL
ADRESA	https://report.al/te-pathenat-e-jetes-se-alket-rizait-mes-burgjeve-te-greqise-dhe-arratisjeve-spektakolare/
BURIMI	report.al
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	27 shtator 2026, 20:18:25 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	27 shtator 2026, 19:07:12 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	61d2e0e6529e33ebb6778cf7fc93ff862ecd3afc42bbc5913ca0be46639e8f52
TEKSTI	3c82d3bdfc355ebcc2be5382ff1109abeecf716d9ce392b64feef6067b5f66cb
PAMJA	884f132e730b5b27051fb9db268b9c515c42c85515bc7e6bca580835c7d1ed6c

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	09100906266f1b0124e5a31e3ef4a98bfd8113f45f12e3dbcd3cbdef263b6b50
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	3aac5177b059e894026952c5b076c374c5dd6b2fda5f20c0a9390b2c535810d8
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/09100906266f1b0124e5a31e3ef4a98bfd8113f45f12e3dbcd3cbdef263b6b50>

PAMJA E FAQES


Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

Home Aktualitet

Të pathënat e jetës së Alket Rizait, mes burgjeve të Greqisë dhe arratisjeve spektakolare

by Bota Bota — September 27, 2026 in Aktualitet, Kronikë

0
SHARES

Share on Facebook

X Share on Twitter

Nëse historia e tranzicionit të Shqipërisë do të kishte qenë ndryshe, edhe fati i qindra mijëra të rinjve që emigruan do të ishte tjetër. Të gjendur mes dallgëve të jetës, disa ia dolën të çajnë përpara, disa mbeten mes tyre, disa u zhytën. Alket Rizai është një prej tyre.

Alket Rizai, 48 vjeç, lindi më 24 maj 1978 në fshatin Aranitas të Ballshit. Deri në moshën 16-vjeçare jetoi mes Ballshit dhe vendlindjes së tij. Familja e përbërë nga 5 persona, dy prindërit dhe dy vëllezërit prej vitesh kanë jetuar në qendër të Ballshit aty ku kishin banesën dhe një lokal të vogël me të cilin siguronin jetesën me vështirësi.

Nuk e harruan asnjëherë edhe vendlindjen e tyre fshatin Aranitas, aty ku edhe Alketi kaloi fëmijërinë e tij, ndërsa ndërtuan edhe një shtëpi në Aranitas në lagjen "Lumar", ku më shumë qëndron babai i Alketit.

Në vendlindjen e Alket Rizait

Emisioni "Drit'hije" udhëtoi në vendlindjen e Alket Rizait, kontaktuam në telefon me familjen e tij, nënën, Donikën dhe të atin Ramizin, tashmë në moshë të thyer. Në pamundësi shëndetësore dhe të lodhur nga vitet e shumta të pritjes ata kishin vendosur të mos dilnin në kamera dhe të flisnin në media që prej herës së fundit në vitin 2013.

"Faleminderit, por unë nuk flas, jam me tension. Unë kam folur 25 vite dhe jam e stresuar, Zoti ma di", janë fjalët e nënës së Alket Rizait.

Në hyrje të Aranitasit ndodhet lokali i fshatit, aty ku mblidheshin burrat e zonës. Aty gjejmë shokë të fëmijërisë, kushërinj, të afërm dhe xhaxhanë e Alket Rizait që rrëfejnë jo pak kujtime me Alketin, që tashmë ka realizuar arratisjen e tretë nga Greqia.

Të afërmit e Alketit zbulojnë pasionet e tij dhe se si ai e kishte kaluar fëmijërinë në fshatin Kalenjë të dajit e tij dhe në Aranitas, dy fshatra ngjitur me njëri-tjetrin. Që në vegjëli ai kishte pasion futbollin dhe peshkimin, ku gjithmonë shkonte të peshkonte në lumin e fshatit.

Ndonëse në shtetin fqinj është i shumëkërkuar, në fshat kanë mendim ndryshe.

Për ta Alketi nuk është vrasës dhe besojnë se është arratisur nga burgu për të vërtetuar të kundërtën për të cilën është dënuar.

Dënimet e Alket Rizait i lidhin edhe me pretendimet që kanë për marrëdhëniet e vendit tonë me Greqinë,

TË FUNDIT

Rokadë ambasadorësh/ Ferit Hoxha ndryshon përfaqësuesit, Meidani në Prishtinë, Malaj në Shkup

SEPTEMBER 27, 2026

"Arrestoni Ramën"/ Mbyllen fjalimet te Kryeministria, protestuesit marshojnë në rrugët e Tiranës

SEPTEMBER 27, 2026

Të pathënat e jetës së Alket Rizait, mes burgjeve të Greqisë dhe arratisjeve spektakolare

SEPTEMBER 27, 2026

Dyshohet se abuzoi sek*ualisht me një fëmijë, arrestohet shqiptari në Amerikë /EMRI

SEPTEMBER 27, 2026

Përfshihet nga flakët banesa në Fier, humb jetën i moshuari

SEPTEMBER 27, 2026

Aksident me motor në Cërrik/ Humb jetën 21-vjeçari pas përplasjes me shtyllën, plagoset edhe pasagjeri 17-vjeç

SEPTEMBER 27, 2026

120 ditë revoltë/ Nis protesta në Tiranë kundër Ramës

SEPTEMBER 27, 2026

Zjarr në Ndërrenas/ Digjen parcelat me ullinj, flakët rrezikojnë sera dhe stalla

SEPTEMBER 27, 2026

Një histori korruptimi jo dashurimi

SEPTEMBER 27, 2026

Stuhia e fuqishme godet bregun lindor të SHBA-së, anulohen mbi 400 fluturime

SEPTEMBER 27, 2026

sepse, sipas tyre, shteti helen nuk i ka trajtuar si duhet shqiptarët në burgje.

Edhe pse me vuajtje dhe dhimbje, familja e Alket Rizait prej rreth 25 vitesh e ka djalin në qeli, nëna e tij ka arritur që ta shohë dhe ta takojë në burg në Greqi.

Nuk është legjendë, por policia greke e ka kërkuar dhe në Aranitas. Banorët tregojnë histori interesante të viteve më parë, kur Alket Rizai ishte arratisur nga burgjet e forcat e rendit kishin ardhur ta gjenin në fshat, madje një herë menduan se e arrestuan. Në të vërtetë ndaluan Alket Rizain, por jo atë që ishte arratisur, por një banor që kishte të njëjtin emër e mbiemër, ndaj e kishin lënë të lirë.

Të afërmit e Alketit kanë edhe një mesazh për të, pasi prej gati 34 vitesh nuk e kanë takuar.

Nga fshati Aranitas largohemi për t'u drejtuar drejt Ballshit, aty ku Alketi jetoi deri në moshën 16 vjeçare dhe kreu edhe shkollën, edhe pse vetën deri në vitin e dytë të gjimnazit, pasi më pas mori rrugën për në Greqi, për të siguruar më shumë të ardhura për familjen. Ai ishte më i vogli i tre djemve dhe ka qenë një fëmijë i shkathët dhe shumë i zgjuar. Që në vegjëli në shkollë ai kishte një pasion të veçantë, të cilin ndoshta mund ta shndërronte në profesion nëse e ardhmja e tij do të ishte ndryshe, elektronikën. Në moshën 10-vjeçare i rregullonte gjithë fëmijëve të qytetit kompjuterat Rambo të asaj kohe.

Ballshi, një qytezë e vogël, që kur përmend emrin e Alket Rizait të gjithë kthejnë kokën për të dëgjuar. Në këtë qytezë, askush nuk i ka dënuar veprimet e tij, ndërkohë që kamera e "Drit'hije" ndaloj para lokalit dhe banesës së prindërve të tij në Ballsh. Biznesi tashmë është mbyllur, ndërsa shtëpia vijon të ketë ende brenda kujtimet e Alketit dhe dy vëllezërve të tij, të cilët po ashtu jetojnë jashtë atdheut.

Në moshën 16 vjeçare në vitin 1994 Alketi u largua në mënyrë ilegale nga malet për në Greqi për të punuar. Malorja e parë e jetës së tij ishin kodrat e kufirit mes dy shteteve të cilat i kaloi në këmbë me shpresën e një jete më të mirë, edhe pse për të historia tregoi të kundërtën.

Kthesa e jetës, nga Aranitasi në Greqi

Fillimisht, në Greqi në moshë të re Alketi punoi si të gjithë të rinjtë shqiptarë pas tranzicionit në emigrim e me të ardhurat ndihmonte familjen në Shqipëri. Në ndihmë i erdhën katër gjuhët e huaja që i fliste. Ndër njohjet e tij të viteve të para në Greqi ishin edhe vajzat simpatike, të cilat shihin te ai djalin simpatik që ngjasonte si një aktor filmi. Alketi u lidh me një vajzë të bukur ruse Oksanën, dhe këtu jeta mori një rrjedhë tjetër. Nga një i ri shqiptar që erdhi në Greqi në moshën 16 vjeç, Alket Rizaj evoluoi në një nga të dënuarit më famëkeq të vendit fqinj.

Në vitin 2003, ai u dënua për vrasjen e Thanasis Koropiotis. Ngjarja ka ndodhur më 3 maj 2003. Autorët e rrëmbyen të riun helen dhe më tej me një makinë e dërguan në pyjet e zonës së Atikës, ku edhe e ekzekutuan e më pas zhdukën kufomën. Fillimisht, policia arrestoi tre persona, dy grekë dhe një ruse, ndërsa një muaj më vonë u ndalua edhe i dyshuari shqiptar. Edhe pse u dënua Alket Rizai nuk e ka pranuar krimin. Por historia më e famshme e jetës së tij kriminale ende nuk ishte shkruar.

Arratisja e parë spektakolare me helikopter në 2006

Në maj të vitit 2003, rojet e burgut gjetën në qelinë e tij një plan të detajuar të burgut dhe menjëherë e transferuan atë në institucionin e sigurisë së lartë të vuajtjes së dënimit Korydallos pranë Athinës. Një nga më famëkeqët në Europë. Ishte shtëpia e vrasësve, kriminelëve të luftës dhe terroristëve.

Pak pasi kishin kaluar gjashtë vite nga dënimi me 25 vite për rrëmbim dhe vjedhje bankash, personazhi i njohur i botës së krimit në Greqi Vasilis Paleokostas u bë mik me Alket Rizain. U deshën vetëm 20 ditë që të hartonim planin e arratisjes. Rizai kishte folur me nënën e tij në telefon dhe i kishte thënë "drejtësia shume shpejt do te shkoje ne vend", edhe pse ajo kurrë nuk e kishte menduar se djali i saj po përgatiste një arratisje.

Më 4 qershor të vitit 2006, në orën 18:15, pranë Athinës, piloti i një helikopteri tregtar, i quajtur Karikis, po hipte në Eurocopter-in e bardhë AS355N.

Ish-ushtaraku ofronte udhëtime për kënaqësi për firmën Airlift, por pesë minuta pasi ishin ngritur një ajër, një nga dy pasagjerët i vuri një armë në qafë. Udhëtimin për kënaqësi i erdhi fundi, ishte Nikos Paleokostas dhe ai do shpëtonte vëllain e tij, Vasilis dhe mikun e tij, shqiptarin Alket Rizai.

Brenda dhjetë minutash, helikopteri mund të shihte burgun Korydallos dhe e reduktoi shpejtësinë në 70 milje për orë.

"Ne shqyrtuam mundësinë për të punësuar një pilot, por një pilot i frikësuar është më mirë," deklaronte Rizai vite më parë në një dokumentar të BBC.

Rojet e burgut, duke menduar se ishte ndonjë autoritet i burgjeve që po arrinte për një inspektim të beftë, rregulluan uniformat. Ndërsa helikopteri u ul në oborrin e stërvitjes, motorët ngritën në ajër një stuhi me pluhur ngjyrë kafe.

Piloti bërtiti: "Ata kanë granata. Ata kanë eksplozivë". Një rojë ulëriti: "Arratisje, arratisje".

Ajo kishte filluar tashmë. Pak momente më vonë, Vassilis Paleokostas dhe Rizai hipën në helikopter dhe ai u ngrit në ajër. Piloti drejtuan armët, por nuk qëlluan sepse a dëgjoi mirë se ç'do ndodhte. Burgu është në një

u ngrit në ajër, ngjitur me qendrën e mbylljes, por nuk qendroi sepse e shpëtoi me shpejtësi nën tokë. Burgu çoi në një zonë rezidenciale me pemë portokalli dhe fëmijët po gjuanin topin në muret e burgut.

Rizai shpjegon: "Qëllimi përfundimtar në një arrati nga burgu është që të largohesh me stil dhe të thuash "Gëzuar" dhe "Bravo" ndërsa largohesh".

Në Skisto, në veri të Athinës, helikopteri u ul me qetësi në një varrezë, aty u shfaqën dy motoçikleta. Paleokostas dhe Rizai ishin nisur për në rrugën e gjatë të lirisë.

Pas arratisjes nga burgu në vitin 2006, Alket Rizai u kap shpejt. Sipas policisë, mësohet se për të humbur gjurmët nga policia greke, kishte ndryshuar luk, kishte lënë mjekër dhe kishte lyer flokët, duke i transformuar nga ngjyrë të zezë në blond. Më 2 gusht 2008, u arrestua edhe Vassilis Paleokostas.

Gjatë periudhës që ishte në arrati, më 26 gusht 2006, Rizai akuzohet se vrau 43-vjeçarin Konstantinos Koutelieris dhe 36-vjeçarin Ioannis Katsios. Rizai asokohe e ka mohuar të jetë përfshirë në këtë krim dhe sipas tij drejtësia greke nuk gjeti kurrë prova ta implikonte. Sipas hetimeve, vrasjet u kryen me urdhër të një prej figurave të fuqishme të mafies greke, Vasilis Stefanakos, i cili u vra vite më pas.

Arratisja e dytë spektakolare me helikopter në 2009

Në vitin 2009 në Athinë do të mbahej gjyqi për Alekt Rizain dhe vëllezërit Paleokostat për arratisjen e vitit 2009. Një turmë u mbledh jashtë gjykatës. Fermerë, fshatarë dhe anarkistë thërrisnin: "Vdekje derrave! Liri për vëllezërit Paleokostas!". Një grup me vajza të reja pushtuan sallën e gjyqit. Në këtë kohë, e dashura magjepsëse e Alket Rizait, Soula Mitropia, bëri bujë në sallën e gjyqit.

Ndërkohë që Rizai kthehej në gjykatë për t'u dënuar me 25 vite, e dashura e tij nisi të qante dhe i hodhi krahët rreth tij. Kur askush nuk po shihte, ajo i futi një orë misterioze në xhep. Pas gjyqit, gjykatësi e dërgoi Paleokostas në qelinë e tij të vjetër në Korydallos, së bashku me Alket Rizain, në pritje të dënimit.

Dhe ajo që ndodhi më 22 shkurt 2009, do i bënte të famshëm në mbarë botën.

Fluturimi i dytë

Për rojet që po shihnin kamerat e sigurisë, ai mëngjes ishte si çdo tjetër. Paleokostas po bënte palestër dhe Rizai po përgjigjente fituesit në një lojë me baste.

Në një dokumentar Rizai kujton: "Jam një njeri që kam intuitë. I ndjej gjërat, kur diçka e mirë do të ndodhë, e ndjej".

Në orën 15:00, e dashura Mitropia i telefonoi në orën- celular që i kishte futur në xhep. Ishte momenti. Sirena e urgjencës në burgun Korydallos nisi të vajtonte si një violinë, ndërkohë që rojet urdhëruan të burgosurit të futeshin brenda. Ishte ora 15:45, një ditë përpara se të niste gjyqi ndaj Rizait dhe Paleokostas.

Sipër në qiell, një rojë nga kulla po ndjente zhurmën e helikave. Kur helikopteri i ul në krahun e djathtë të burgut, roja kapi automatikun dhe i ra alarmit.

Nuk ishte një stërvitje, këtë herë ata duhet të qëllonin për të vrarë. Helikopteri ishte rrëmbyer nga një kompani e quajtur Interjet, që i ofronte me qira. Në bordin e mjetit fluturues AS355N kishte hipur një bukuroshe e quajtur "zonjusha Alexandrova". Pasi nxori një granatë dore nga çanta, i tha pilotit: "Le të shkojmë të marrim djemtë. Burgu Korydallos ose do vdesësh".

Ndërkohë që helikopteri fluturonte mbi burg, ajo u hodhi poshtë Alket Rizait dhe Paleokostas-it një shkalë prej litarësh. Ajo grua mendohet se ishte Mitropia, e dashura e Alket Rizait.

Një roje i dëshpëruar u vu pas tyre, por Alket Rizai nxori një hell qepapësh dhe e paralajmëroi: "Tërhiq ose do të ta ngul". "Të ikim," bërtiti Paleokostas dhe piloti e ngriti levën në maksimum.

Poshtë në burg dukej sikur ishte një turmë me tifozë në një ndeshje futbolli, të dënuarit përshëndesnin dhe brohorisnin. Por sapo u mbyll dera e helikopterit, tre roje kapën automatikët e tyre MP5 dhe nisën të qëllojnë, duke goditur me mbi 30 plumba mjetin e arratisë. Një prej tyre ra në depozitën e karburantit, që nisi të shpërndahej në kabinë dhe piloti nisi që të thoshte një lutje. Edhe pse i qëlluan, plumbat nuk kapën askënd.

Në të njëjtën kohë, një grua nga një apartament aty pranë nisi të regjistronte me kamera një video që është kthyer në hit në YouTube.

Në fund për shkak të karburantit bënë ulje emergjence. Lajmi në mbarë Greqinë, por edhe botën ishte arratisja e dytë nga burgu e Alket Rizait dhe mikut të tij Paleokosta. Këtëj e andej kufirit nisën lajmet e legjendat për aventurat e Alket Rizait. Rizai, Mitropia dhe Paleokostat.

Disa muaj më vonë, më 17 nëntor 2009, Rizai u arrestua përsëri në Grammatiko, së bashku me partneren e tij Aspasia Mitropia, e njohur në shtyp si "Sula e Rizait".

2013, tentativa e tretë e arratisjes. Alket Rizai merr peng gardianët

Historia e arratisjeve nuk mbaron me kaq. Në korrik të vitit 2011, nga burgu i Grevenës, Alket Rizai njoftoi një arratisje të tretë, gjatë një interviste për Gazeta Shqiptare.

"Grekët më kanë marrë vitet më të bukura të jetës sime, kështu që unë do të iki përsëri. Nuk do të ndalem,

më mirë të më vrasin”, deklaronte Alket Rizai.

Në vitin 2013, tentoi ikjen e tretë, këtë herë nga burgu i Malandrinos. Ai mori peng pesë roje burgu dhe pasoi një negociatë e gjatë me autoritetet. Nga Shqipëria, nëna e tij i dha mesazh përmes mediave.

Pas rreth 24 orësh, më në fund Rizai iu dorëzua Policisë.

25 vite në burgjet e Greqisë, Alket Rizai mbrojtësi i shqiptarëve të burgosur

Nëse nuk do të kërkonte dëshpërimisht lirinë me bindjen apo pretendimet se dënimet e përgjeshme ishin të padrejta, sepse krimet për të cilat akuzohej nuk i kishte bërë realisht ai, Alket Rizai do të ishte as më shumë e as më pak një shqiptar më tepër në burgjet greke. Dy arratisjet e tij të bujshme me helikopter bën jehonë në mediat ndërkombëtare, ndërsa shteti grek u detyrua të pranonte inteligjencën e lartë të shqiptarit nga Mallakstra.

Por gjatë viteve në burg raportohet se ka qenë një mbështetje e madhe për shqiptarët në burgjet e Greqisë duke i mbajtur pranë vetes. Fotot nga qelitë tregojnë vëllazërinë e tij, ku nuk mungon kurrë flamuri kombëtar kuqezi por nuk mungojnë as pasionet e tij, futbollit. Një tifoz i çmendur i Barcelonës që në vegjëli, ku fanella e katalanasve është ajo e preferuara.

Alket Rizai i frymëzuar nga revolucionarët, idhulli i tij “Che Guevara”

Idhulli i Alket Rizait është Ernesto Che Guevara që e gjen në çdo qeli ku ka qenë. Motoja e Rizait i frymëzuar nga shprehja e famshme: “Më mirë të vdes në këmbë sesa të jetoj në gjunjë.”

Shprehje, e cila është shkruar në murin e çdo qelie që ai ka qëndruar i burgosur.

Metamorfoza e Alket Rizait

Ndryshimi i pamjes së Alket Rizait ndër vite tregojnë qartë jetën e vështirë që ka kaluar në burgjet e Greqisë. Emisioni “Drit’hije” publikon pre herë të parë pamje te fundit të tij. Një ndryshim drastik në pamje, që për dikë që mund ta shohë për herë të parë, nuk do ta njihte që është Alket Rizai, por ai vijon gjithmonë të jetë në këmbë dhe emri i tij në qendër të vëmendjes, duke u bërë një nga personazhet më të përfolur në mediat greke në 25 vitet e fundit në kronikën e zezë. Madje këngëtari grek Tus ka bërë edhe një këngë kushtuar Alket Rizait. Këngëtari Tus u sulmua nga ekstremistët grekë për këngën që i kushtoi Rizait.

Alket Rizai tjetër

Në 4 shtator 2017, tërhoqi sërish vëmendjen e opinionit publik, por këtë herë me një gjest human. Ai angazhoi të dënuarit e tjerë në burgun ku ai vuante dënimin, që të paguanin para për të mbledhur të ardhura në ndihmë të vogëlushes 8-vjeçare Evangelia Kastrinaki. E mitura nga Kreta ishte diagnostifikuar me kancer, dhe për të marrë një trajtim të specializuar në Britani të Madhe, i duheshin para, familja e së cilës nuk i kishte dhe beri apel ne televizion. Alket Rizai telefonoi të atin e vajzës dhe i tha se mblodhi lekë nga të burgosurit për të dhënë sadopak ndihmë në shpëtimin e jetës së vajzës 8-vjeçare.

Viti 2013, Alket Rizai: Do të tentoj të arratisem gjithmonë! 14 shtator 2026, shqiptari mban fjalën, arratiset sërish

Në shtypin shqiptar në Greqi në gazetën “Tribuna”, 13 vite më parë Alket Rizai ka deklaruar se do të jetë gjithmonë i gatshëm për t’u arratisur.

Pas dy arratisjeve të bujshme në 2006 dhe 2009, qëllimin e arrin më 14 shtator 2026. Pasi mori një leje të përkohshme nga burgu, ai duhej të kthehej mëngjesin e 14 shtatorit në burgun e sigurisë së lartë të Domokosit, por u shpall zyrtarisht në kërkim pasi nuk u paraqit.

Më 13 shtator, ai u përfshi edhe në një përplasje me armë jashtë një bari në plazhin e Anavissosit, pranë Athinës. Sipas mediave greke, Rizai doli nga bari i shoqëruar nga disa persona dhe ndezi në automjetin e tij, muzikë me volum të lartë. Ai nisi një debat të ashpër me pronarin e barit, i cili iu afrua dhe i kërkoi të ulte volumin. Debat i shoqërua me të shtëna me armë, por dinamika ende mbetet e paqartë. Ajo që dihet është se rojet e plazhit qëlluan të parët me armë në drejtim të Rizait, i cili më pas u largua. Mediat greke raportojnë se u qëllua nga të dy palët. Nga viti 2021, Rizai kishte përfutur më parë 16 leje dhe nuk kishte shkelur asnjëherë prej tyre, e fundit e 17 mori emrin e lirisë.

Tashmë Alket Rizai është i lirë. Ai është dënuar dy herë me burgim të përgjeshëm nga Gjykata e Apelit në Greqi edhe pse së fundmi kishte kërkuar lirinë me kusht. Kushti i tij i vetëm është vetëm arratisja atë që di ta bëjë më mirë se kushto tjetër.

Në fund, historia e Alket Rizait nuk është vetëm historia e një njeriu që u kërkua, u gjet, u burgos, u arratis, u burgos sërish, u arratis e kështu me radhë. Është edhe historia e një metamorfoze. E një njeriu që teksa vitet kalonin, ndryshonte pamje, vende, por në karakter vijon të jetë po ai. Një njeriu i cili mësoi të humbiste gjurmët, të zhdukej për të rishfaqur veten diku tjetër, ashtu si sot, ku pyetja është: Ku do shfaqet sërish?

/A2 CNN

Previous Post

Dyshohet se abuzoi sek*ualisht me një

Next Post

“Arrestoni Ramën”/ Mbyllen fjalimet te

fëmijë, arrestohet shqiptari në Amerikë
/EMRI

Kryeministria, protestuesit marshojnë në rrugët
e Tiranës



Bota Bota



RUBRIKAT

MË TË KLIKUARAT

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.